



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:282144

Datë: 09.01.2024

Numri i dokumentit: 05167755

**C -III- 15- 0044**

**Paditës/ Propozues :** Z R nga fshati L, Komuna Graçanicë, i përfaqësuar nga avokati D L .

**Kundër :**

**Të Paditurit/ Kundërshtarë të sigurimit :** KBI „Kosova Export ” Fushë Kosovë e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Driton Hoxha nr. 55, Prishtinë, të cilën e përfaqëson N K .N M.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me kolegjin e specializuar gjyqtarin kryesues Hasim Sogojeva, dhe gjyqtaret Shkelzen Sylaj dhe Asllan Krasniqi, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike më dt. 11.12.2023, në lidhje me propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit , mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**Propozimi për caktimin e masës së sigurimit i ushtruar nga propozuesi Z R, konsiderohet i tërhequr .**

#### **Rrethanat e Faktike**

Më dt. 14.01.2015, paditësi /propozuesi ka ushtruar padi për njohjen e drejtës së pronësisë në ngastra kadastrale nr..., me sipërfaqe prej 1,85.79 ha, ngastra..., me sipërfaqe 0,73.27ha, ngastra..., me sipërfaqe 60.66ha, ngastra .., me sipërfaqe 076.23ha, ngastra nr..., me sipërfaqe 0.85.39 ha, ngastra nr....., me sipërfaqe 0.83.39ha, të gjitha të regjistruara në fletën e posedimit , ZK Graçanicë , nga baza juridike e Aktvendimit të Komisionit përkthimin e Tokave të Komunës së Prishtinës .

Në padi ka bashkangjitur Aktvendimin e Komunës së Prishtinës, nr. - 452- 23/91, dt. 12.10.1992.

Më dt. 23.12.2022, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën e përgjigjes në padi me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetim se paditësi nuk ka dorëzuar në origjinal Aktvendimin e Komunës së Prishtinës .

Më dt. 02.03.2021, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtrësën me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen në padi, dhe ka theksuar se Aktvendimi i Komisionit për Kthimin e Tokave gjendet në Arkiv të Republikës së Kosovës, por edhe përkundër kësaj ne kemi ushtruar kërkesë për vërtetimin e kopjes nga origjinale dhe gjykatës do ja sjellim.

Më dt. 10.05.2023, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër C-III- 15- 0044, për paditësin/ të autorizuarin dhe ju është kërkuar të dorëzon një ekspertizë gjeodezike për identifikimin e ngastrave lëndore, pastaj të dorëzon në origjinal aktvendimin si dhe të paguan taksën gjyqësore në lartësi 100€.

Më dt. 30.05.2023, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtrësën dhe së bashku me parashtrësë ka dorëzuar ekspertizën gjeodezike të ekspertit A C, dt. 26.05.2023, dhe Aktvendimin 06- 462-23/91, dt. 12.10.1992, të vërtetuar nga origjinale te noteri S K, LRP 4836/2013. Po ashtu ka dorëzuar edhe dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore.

Më dt. 14.07.2023, i autorizuari i paditësit ka ushtruar propozimin për caktimin e masë së sigurimit, me të cilin ka kërkuar që Kundërshtarit të Sigurimit Agjencia Kosovare e Privatizimit ti ndalohet të tjetërsoi ngastrat kadastrale, nr. ....,.....,.....,.....,.....të gjitha në ZK Graçanicë .

Urdhërohet Zyra e Kadastrit ta regjistroi këtë masë të sigurimit.

Më dt. 02.08.2023, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën me të cilën e ka kundërshtuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit .

Më dt. 11.12.2023, DHPGJS , ka vendosur të mbajt një seancë dëgjimore lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit , në të cilën në mënyrë të rregullt është ftuar i autorizuari i propozuesit avokati D L që e ka pranuar njoftimin, më dt. 31.10.2023, sikundër edhe AKP-ja

Në seancë dëgjimore, të datës 11.12.2023, ka munguar i autorizuari i paditësit, avokati D L , ndërsa ka prezantuar për AKP- në me autorizim N K .

Përfaqësuesi i AKP-së : është deklaruar se e kundërshton propozimin për caktimin e masë së sigurimit, me arsyetim se ngastrat lëndore tani ato nuk janë në emër të NSH –së, por janë në emër të personave fizik dhe në seancë ka dorëzuar : Certifikatat e pronës për ngastrat , nr. ..-, që është në emër të F R, ..., në emër të H B, ..., në emër të A G, ngastra..., në emër të Xh K, ngastra..., në emër të R Sh, ngastra..., në emër të B B, ngastra .., në emër të N B, ngastra ..,në emër të I A, .., në emër të E P,..., në emër të B B1,..., në emër të N B,..., në emër të V R, ... në emër të B B2, ..,në emër të B B3, ...,në emër të B B4 .....,në emër të B B5 .....,në emër të D K, ..., në emër të F R etj.Përkundër faktit se kundërshtojmë propozimin,propozuesi nuk është paraqitur në seancë, ne kërkojmë që Gjykata propozimin ta konsideroi të tërhequr .

### **Arsyetimi Ligjor**

### **Propozimi i propozuesit konsiderohet i tërhequr**

Me nenin 58 të Ligjit nr. 06/L-086, është paraparë ,, 1. Nëse pala kundërshtare, të cilës i është dorëzuar kërkesa, nuk paraqitet në seancë dëgjimore për të cilën është njoftuar sipas rregullit dhe me kohë, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, sipas detyrës zyrtare, apo në bazë të kërkesës së Parashtruesit, mund të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër palës kundërshtare. 2. Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale. 3. Para nxjerrjes së një aktgjykimi për mosparaqitje, gjyqtari(ët) gjegjës vlerëson se janë përmbushur të gjitha këto kushte: 3.1. kërkesa është e pranueshme; 3.2. faktet e pretenduara nga Parashtruesi mbështesin kërkesën. ”

Me dispozitën e nenit 409.1 të Ligjit për procedurë kontestimore është paraparë ,, Në qoftë se në seancë përgaditore nuk vjen paditësi , edhe pse është thirr në mënyrë të rregullt , padia konsiderohet e tërhequr , përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet ”

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësi/propozuesi ishte ftuar në mënyrë të rregullt pasi njoftimin për mbajtjen e seancës dëgjimore publike të caktuar për dt. 11.12.2023 , e kishte pranuar i autorizuari i propozuesit më dt.31.10.2023 dhe s’ bashku me njoftim ka pranuar edhe njoftimin për pasojën juridike nëse nuk prezenton në seancë dëgjimore, në lidhje me zbatimin e nenit 58 të Ligjit nr. 06/L-086.

Në rastin konkret përfaqësuesi i AKP-së, kërkoi nga Gjykata të konsiderohet i tërhequr propozimi , ai nuk kërkoi të mbahet seanca dëgjimore , të njëjti propozim e pranoi

Gjykata vlerëson se në rastin konkret konsiderohet se propozuesi është tërhequr nga propozimi pasi nuk është paraqitur në seancë dhe në analogji vendosi ta zbatoi 58 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit nr. 06/L-086 e në lidhmeri me nenin 409.1 të LPK-së.

Për këtë arsye edhe është vendosur si në dispozitiv .

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar Kryesues

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

Asllan Krasniqi Gjyqtar